



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 223, datë 08.05.2023

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË MUNDËSISË FIZIKE DHE MENDORE PËR USHTRIMIN E FUNKSIONIT TË GJYQTARIT NGA Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 67 të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi u njoh me raportet mjekësore të njëpasnjëshme, të vëna në dispozicion nga gjyqtari {...}, në funksion të shqyrtimit të procedimeve disiplinore nr.3/2022, nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023 të filluara sipas kërkesave së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. {...}, gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Kukës.
2. Të ngarkojë Komisionin e Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen dhe kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për efekt të kësaj procedure.
3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet gjyqtarit z. {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR